




KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren - Tel.: 029/ 244 150
e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Për Zyrën Kombëtare të Auditimit

Zenel Zenelaj, Kryeshef Ekzekutiv

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1.	Baza për opinion Çështja A1 - Mos përputhje e detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël të Kompanisë me gjendjen në ATK	Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, përkatësisht pika 1 përcakton se: Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmimeve të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Po ashtu, neni 12, pika 2 ndër tjera përcakton se: Inventarizimi	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që të identifikohen dhe harmonizohen detyrimet tatimore të kompanisë me gjendjen e llogarive në ATK.	Ky rekomandim është i lidhur me llogaritë e arkëtueshme. Llogaritë e arkëtueshme që plotësojnë kushtin e trajtimit si borgje të këqija, do t'i		Do të fillohet me zbatimin e rekomandimit gjatë vitit fiskal 2022, si dhe do të vazhdohet edhe viteve në vijim, sipas dinamikës së trajtimit të llogarive të arkëtueshme.	

		<p>duhet të barazohet me librat kontabël. Kompania kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar detyrime ndaj Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh-së) shumën 1,496,887€, ndërsa bazuar në gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit si dhe pas konfirmimit të pranuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), kompania nuk kishte detyrime për këtë llogari tatimore, përkatësisht gjendja e borxheve ndaj ATK-së ishte zero.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël për vitet e mëhershme, me gjendjen e deklarimeve dhe borxheve në ATK.</p>		<p>paraqiten Bordit të Drejtorëve për aprovim si borgje të këqija, si dhe do të merret aprovimi edhe nga ZKA, për një veprim të drejtë.</p>		
2.	<p>Çështja A2 - Mungesa e politikave të qarta dhe analizave të mjaftueshme për lejimet ndaj të arkëtueshmeve</p>	<p>Sipas SNRF 9 Instrumentet financiarë, paragrafi B5.5.35 përcakton: një njësi ekonomike mund të përdorë mjete praktike të volitshme kur mat humbjen e pritshme të kredisë nëse ato janë në përputhje me parimet e paragrafit 5.5.17. Një shembull i një ndihmese të tillë është llogaritja e humbjeve të pritshme të kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare duke përdorur një matricë provizionesh. Njësia ekonomike do të përdorë përvojën e saj historike të humbjes së kreditit (e rregulluar sipas nevojës në përputhje me paragrafët</p>	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë zbatim të plotë të SNK-ve dhe SNRF-ve në mënyrë që të vendosë një politikë të përshtatshme për lejimet ndaj llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, kompania duhet të aplikojë një rishikim gjithëpërfshirës dhe detal të saldosh të llogarive të arkëtueshme për një</p>		<p>Do të përmbushet gjatë vitit fiskal 2022 dhe me përpilimin e pasqyrave financiare 2022</p>	

	<p>B5.5.51-B5.5.52), si një praktikë të përshtatshme, për llogaritë e arkëtueshme tregtare për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë për periudhën 12-mujore ose humbjet e pritshme të kredisë për tërë jetën e aktivitetit financiar. Në varësi të larmisë së klientëve të saj, njësi ekonomike do të përdorë grupimet e përshtatshme në qoftë se përvoja e saj historike e humbjeve të kredisë tregon modele të ndryshme humbjeje për segmente të ndryshme të klientëve.</p> <p>Nga saldo bruto e llogarive të arkëtueshme (LLA) prej 12,347,325 € lejimet e akumuluar për LLA deri më 31 dhjetor 2021 ishin 7,496,349€.</p> <p>Kompania nuk kishte politika të shkruara dhe nuk kishte kryer analiza të mjaftueshme të cilat mbështesin parashikimet e menaxhmentit të bëra në lidhje me saldon e lejimeve të akumuluar të llogarive të arkëtueshme.</p> <p>Vlen të theksohet se lejimi në vlerë prej 541,371€ i LLA për vitin 2021 ishte bërë pa ndonjë analizë të strukturuar të llogarive të arkëtueshme. Prandaj, në mungesë të këtyre analizave, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri</p>	<p>pasqyrim sa më të drejtë të tyre në pasqyra financiare.</p>				
--	---	--	--	--	--	--

		<p>të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare prej 4,850,976€.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se Kompania ndër vite nuk kishte aplikuar një politikë të përshtatshme dhe konsistente të lejimeve të llogarive të arkëtueshme.</p>				
3.	<p>Çështja A3 - Pamundësia e konfirmimit të bilanceve të llogarive të arkëtueshme dhe mungesa e dokumenteve burimore për ish ndërmarrjet shoqërore</p>	<p>Sipas Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim neni 12 përkatësisht pika 1 përcakton se: Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmimeve të tyre mbështetëse nepermjet procesit të inventarizimit. Nga 20 konfirmime të kërkuara nga debitorët, janë kthyer vetëm dy (2) sosh në vlerën financiare 26,632€, ndërsa për 18 të tjera në vlerë prej 387,560€ nuk janë kthyer fare konfirmimet. Nga konfirmimet që nuk janë kthyer, në 10 raste në vlerë prej 226,508€, sipas zyrtarëve të kompanisë konsumatorët nuk ekzistojnë ose nuk janë të identifikueshëm, në mungesë të dhënave të sakta, ndërsa për 8 raste të tjera në vlerë prej 161,052€ klientët kanë refuzuar të ta konfirmojnë gjendjen, sepse ato ishin borxhe të vjetra dhe</p>	<p>Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë procedura të harmonizimit periodik të llogarive me debitorët. Për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë privatizuar, kompania duhet ta diskutoj çështjen e borxheve të pa paguara me Agjencinë Kosovare të Privatizimit e cila ka administruar procesin e transformimit të pronësisë dhe detyrimeve.</p>	<p>Do të kontaktohen zyrtarë nga AKP-ja për t'u pajisur me dokumentet burimore të ish NSH-ve për të cilat disponon AKP-ja, njëkohësisht vendimet e shkallës së prerë do të ekzkutohen në kartelat e konsumatorëve në databazën e konsumatorëve.</p>		<p>Do të përmbushet gjatë vitit fiskal 2022-2023 dhe 2024 dhe me përpilimin e pasqyrave financiare të secilit vit, varësisht se si do të procedohen vendimet nga AKP-ja.</p>

		<p>rastet janë në procedura përmbartimore. Disa prej tyre ishin ndërmarrje shoqërore, të cilat tashmë janë privatizuar. Megjithatë, edhe pse nuk janë kthyer konfirmimet, ne kemi kryer procedura alternative shtesë dhe në dy raste tek ish-dërmarrjet shoqërore kemi identifikuar mos përputhje në vlerë prej 178,363€ në mes saldosh të llogarive të arkëtueshme të prezantuara në pasqyrat financiare (70,548€) dhe dokumenteve burimore (248,911€).</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte bërë procesin e inventarizimit-harmonizimit të gjendjeve me klientë në baza periodike.</p>				
4.	<p>Çështja A4 - Mos përputhje mes shënimeve në kontabilitet me detyrimet ndaj grantit të prezantuar në pasqyra financiare</p>	<p>Njëra nga metodat e paraqitjes së granteve në kontabilitet sipas SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese, paragrafi 26 njihet si e ardhur të shtyrë e cila njihet si e ardhur në një mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të aktivitetit. Vlera e të hyrave të shtyra nga grantet (detyrimet ndaj grantit) e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar 2021 ishte 19,791,975€ ndërsa sipas shënimeve analitike të vlerës së mbetur të pasurive dhe investimeve në vijim të përfituara nga grantet ishte 19,833,335€, pra ekziston një diferencë prej 41,360€.</p>	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për identifikimin e këtyre diferencave dhe të bëhen korrigjime adekuate në kontabilitet.</p>			<p>Do të përmbushet gjatë vitit fiskal 2022 dhe me përpilimin e pasqyrave financiare 2022.</p>

		<p>Kjo diferencë ishte rezultat i saldove të bartura prej viteve të kaluara, dhe gjatë kohës së ekzekutimit të auditimit zyrtarët e kompanisë nuk ishin në gjendje të dokumentojnë se cila ishte vlera e saktë e granteve.</p> <p>Kjo diferencë kishte rrjedhur nga saldot e bartura prej viteve të kaluara, dhe gjatë kohës së ekzekutimit të auditimit zyrtarët e kompanisë nuk ishin në gjendje të identifikojnë se cila ishte vlera e saktë.</p>				
5.	Çështja A5 - Mbivlerësim i të ardhurave	<p>Sipas SNK 18 Të ardhurat, paragrafi 14 përcakton se: Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve do të njihen kur të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet vijuese (ndër të tjera): është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike; dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.</p> <p>Gjatë vitit 2021 Hidroregjioni Jugor kishte paguar taksa në vlerë prej 32,045€ ndaj përmbauesve, dhe vlerën prej 27,157€ e kishte njohur gabimisht në kontabilitet si të hyrë të vitit. Taksat e përmbauesit janë të rimbursueshme në rast se lëndët e dërguara në përmbaues arrijnë të përmbaohen në interes të kompanisë. Prandaj, në rastin konkret lëndët janë në procese</p>	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të bërë korrigjimet adekuate në kontabilitet, dhe njohja e të hyrave të bëhet vetëm pasi që lënda të jetë përfunduar.</p>			<p>Do të përmbushet gjatë vitit fiskal 2022 dhe me përpilimin e pasqyrave financiare 2022.</p>

		<p>përmbare dhe ende nuk janë të përfunduara për t'i njohur si të hyra në regjistrimet kontabël.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se Kompania ka aplikuar regjistrime të gabuara kontabël duke njohur aktivet e kushtëzuara si e ardhur e vitit, ende pa u plotësuar kushti për një veprim të tillë.</p>					
6.	<p>Çështja A6 - Njohja e obligimeve në periudhën e gabuar</p>	<p>Sipas SNK 1, Paraqitja e Pasqyrave Financiare, paragrafi 25 përcakton se: Një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat e saj financiare, me përjashtim të informacionit lidhur me fluksin monetar, duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.</p> <p>Kompania gjate muajit janar 2022 kishte pranuar një faturë në vlerë prej 9,370€ që paraqet zbritjen tregtare për shpenzimet e telefonisë mobile të muajit dhjetor 2021. Kjo zbritje tregtare nuk ishte regjistruar në kontabilitet në periudhën e duhur dhjetor 2021, por ishte regjistruar në janar 2022.</p> <p>Kjo kishte ndodhur si rezultat i trajtimit të gabuar kontabël sepse një zbritje në faturën e datës 06.01.2022 prej 9,370€ nuk ishte regjistruar në periudhën përkatëse të cilës i përkiste (dhjetor 2021).</p>	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marr veprimet e nevojshme për të bërë korrigjimet adekuate në kontabilitet për llogaritë e pagueshme.</p>			<p>Do të përmbushet gjatë vitit fiskal 2022 dhe me përpilimin e pasqyrave financiare 2022.</p>	

7.	<p>Çështja A7 - Trajtimi i gabuar kontabël i donacioneve</p>	<p>Vendimi Shpjegues Publik nr. 04/2016 Trajtimi i Donacioneve për qëllime tatimore përcakton se: Projektet e financuara nga të ardhurat e donacioneve, sipas nenit 33, paragrafit 3 dhe nën paragrafit 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) trajtohen si transaksione të eksporteve, për të cilat furnizuesi i mallrave/shërbimeve, do të faturojë pa TVSh me të drejtë të zbritjes së TVSh-së së zbritshme. Implementuesi i projektit, për të gjitha blerjet e mallrave/shërbimeve të parapara me projekt, lirohet direkt nga TVSh në blerje, nëse blerjet e tilla bëhen nga të ardhurat e donacioneve.</p> <p>Hidroregjioni Jugor kishte realizuar 3 projekte në rrjetin e ujësjiellësit në regjionin e Prizrenit përmes donacioneve nga komuna e Suharekës dhe Komuna e Prizrenit. Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se Hidroregjioni nuk i kishte regjistruar siç duhet 4 fatura që ishin realizuar nga projektet e tilla.</p> <p>Vlera e faturave ishte 109,176€.</p> <p>Ne kemi vërejtur se Kompania kishte aplikuar regjistrime të gabuara kontabël duke njohur pjesën e TVSh-së së këtyre faturave si e ardhur e vitit, në vend se e gjithë vlera e faturave të njëjtit si detyrim ndaj grantit.</p>	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se do të bëhen korrigjimet adekuate në kontabilitet dhe në rastet e financimit të projekteve nga donacionet të merren në konsideratë kërkesat ligjore si dhe të zbatohen kërkesat e SNKve në përgatitjen e pasqyrave financiare.</p>			<p>Do të përmbushet gjatë vitit fiskal 2022 dhe me përpilimin e pasqyrave financiare 2022.</p>	
----	---	---	--	--	--	---	--

		Vlera e TVSh-së e njohur si e ardhur e vitit ishte 16,654€. Kjo kishte ndodhur për shkak se Kompania kishte aplikuar regjistrime jo adekuate duke njohur vlerën neto të faturave si e hyrë e shtyrë (detyrimet ndaj granteve) ndërsa pjesën e TVSh-së si e ardhur e vitit.					
8.	Çështja A8 - Parashkrimi i borxheve të konsumatorëve	<p>Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 360 paragrafi 1 përcakton se shërbimet e ujësjellësit për konsumatorët shtëpiak-amvisëri janë kërkesa që parashkruhen pas një viti, ndërsa neni 355 përcakton se: Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.</p> <p>Sipas shënimeve të siguruara nga zyra ligjore, Kompania kishte bërë 38 kërkesa ndaj klientëve në vlerë totale prej 63,188€. Këto kërkesa ishin proceduar tek përmbartuesi e të cilat nga palët ishin prapësuar në gjykatë dhe gjatë vitit 2021 me vendim të formës së prerë të gjykatës, vlera e borxhit prej 52,407€ ishte parashkruar apo 83% e borxhit të kontestuar.</p> <p>Më tutje, sipas të dhënave në sistemin e faturimit, kërkesat ndaj konsumatorëve ishin gjithsej 12,115,693€. Prej tyre</p>	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që Kompania po ndërmerr me kohë veprimet ligjore që parandalojnë parashkrimin e borxheve dhe të intervenojë në sistemin e faturimit ashtu që faturat e paguara dhe ato të pa paguara të jenë të identifikueshme.	Do të shikohen rrugë dhe mënyra që shumën e parashkrimit të borxheve të jetë sa më e vogël. Në konsultim me shërbimin juridik do të gjenden modalitete të cilat do të ndalojnë parashkrimin e borxheve të konsumatorëve		Do të përmbushet gjatë vitit fiskal 2022-2025.	